



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "NDRE MJEDA'BUSHAT, VAU-DEJES

Nr. 1 prot.

Vau i Dejës 13/1/2022

Lënda: Njoftim për vend të lire pune

**DREJTORISE SE SHERBIMEVE MBESHTETESE
DREJTORISE E MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021 ..., "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Ofruesi publik i AFP- së , shkolla e Mesme Profesionale "Ndre Mjeda", ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

1 mësimdhënes i Teorisë Profesionale , në drejtimin Bujqësi me kohë të plotë.

- Kriteret e Përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

1. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

3 . Dokumentet e aplikimit :

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin,
- b) jetëshkrimin (CV-në) sipas shtojces 11 të këtij udhezimi
- c) kartën e identitetit,
- d) diplomën ,
- e) librezën e punës,
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit,
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore,
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore,
- j) vërtetim nga punëdhënësi I fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi, të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi I mëparshëm,

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje, datës 26/01/2022

Drejtori I shkollës

Ruzhdi KAPIDANJA

